

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje kompjuterike+ printer skaner fotokopje me ngjyra +printer A4”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kompjuter Desktop – 30213300 -8

Vlera e fondit limit **4,094,833** (katër milion e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Nr3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizës së Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas sipas shtojcës përkatëse të DST-se.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari

ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur furnizimi i një natyre të ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë me vërtetime të lëshuara nga ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Kur furnizimi i një natyre të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë vetëm me fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikes 4, nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e

kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve të punonjesve të Prokurorisë së Posaçme, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**. Certifikatat duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv

të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

2.3.4 Operatori ekonomik duhe të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO/IEC 20000-1:2018 (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit) ose ekuivalente**. Certifikatat duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të shërbimeve. Mund të implementohet dhe certifikohet nga çdo ofrues i shërbimit, pavarësisht nga specifikat e shërbimeve që ofron.

Ky standard i kërkon shoqërisë ndër të tjera, të kontrollojë furnizuesit që marrin pjesë në procesin e ofrimit të shërbimit; të monitorojë nivelin e kënaqësisë së klientit, të ketë mekanizma të përshtatshme për të menaxhuar incidentet, kërkesat dhe problemet; të vlerësojë kostot e shërbimeve të saj ose të kontrollojë në mënyrë të duhur ndryshimet.

Mbajtja e një certifikimi ISO/IEC 20000-1 konfirmon angazhimin e shoqërisë për të ofruar shërbime që plotësojnë kërkesat e AK e dhe për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhe të paraqesë certifikatë të menaxhimit të **ISO 27001:2022 (për Sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente**. Certifikatat duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ky standard specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë së informacionit dhe veprimi ndaj këtyre rreziqeve (i ashtuquajtur “trajtimi i rreziqeve”) përmes kontrolleve të sigurisë së informacionit në pajtim me kërkesat e standardit përfaqësojnë

një bazë të sigurt për të siguruar konfidencialitetin, disponueshmërinë dhe integritetin e informacionit përkatës dhe arritjen e objektivave të dëshiruara të sigurisë. Siguron një kornizë për zbatimin e politikave, procedurave dhe masave në proceset e menaxhimit të rrezikut të informacionit të organizatës. Nisur nga rëndësia e kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog në gjuhën shqipe ose në rastin kur është në gjuhë angleze ose tjetër, e përkthyer dhe e noterizuar për çdo produkt, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknike të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit objekt kontrate, duhet të ketë staf teknik te kualifikuar për implementimin e projektit, sipas certifikatave te meposhtme si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjes së serverit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent
- b) Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemit të backup&replication që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent
- c) Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet firewall që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional, për “Sistem për mbrojtjen endpoint EDR” ose ekuivalent

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmimeve të kërkuara.

Për secilin punonjes të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.

- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet të figurojnë.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas sipas shtojcës përkatëse të DST-se. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve objekt prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i diplomuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomike ofertues. Këto janë dokumenta provuese që i shërbejnë Autoritetit Kontraktor që punonjësit e deklaruar nga operatori ekonomik disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Konkretisht:

- 1) Per kriterin ne pikën **a**) Duke qene se AK do te instaloje 1(nje) server ne infrastrukturen e re , shikohet e arsyeshme që Operatori Ekonomik të këte në stafin e propozuar 1 (nje) staf teknik te kualifikur me certifikatat përkatëse .
- 2) Per kriterin ne pikën **b**) Meqenëse infrastrukturura që kerkohet të ndërtohet duhet të mbështetet në teknologji backup&replication , për manaxhimin me cilësi të këtij komponenti shikohet e arsyeshme që Operatori Ekonomik të këte në stafin e propozuar 1 (nje) staf teknik te kualifikuar me certifikatat përkatëse që vërtetojnë këtë nivel ekspertize të kërkuar.
- 3) Per kriterin ne pikën **c**) Meqenëse infrastrukturura që kerkohet të ndërtohet do te instalohen dhe konfigurohet nje Firewall i cili ka rendesi primare dhe për manaxhimin me cilësi të këtij komponenti shikohet e arsyeshme që Operatori Ekonomik të këte në stafin e propozuar 1 (nje) staf teknik te kualifikuar me certifikatat përkatëse që vërtetojnë këtë nivel ekspertize të kërkuar. Niveli i kërkuar profesional garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës.
- 4) Per kriterin ne pikën **d**) Meqenëse infrastrukturura që kerkohet të ndërtohet do te instalohen nje sistem per mbrojtjen endpoint detection and response EDR dhe për manaxhimin me cilësi të këtij komponenti shikohet e arsyeshme që Operatori Ekonomik të këte në stafin e

propozuar 1 (nje) staf teknik te kualifikuar me certifikatat perkatëse që vërtetojnë këtë nivel ekspertize të kërkuar. Niveli i kërkuar profesional garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku konfirmon se do të kryejë konfigurimin dhe implementimin e sistemeve dhe pajisjeve, si dhe te marrë përsipër trajnimin e përdoruesve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Konfigurimi, implementimi dhe trajnimi është i rëndësishëm për vënien në punë dhe funksionalitetin e sistemeve.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor Brenda afatit të parashikuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar)

Në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 141, datë 22.2.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit” e ndryshuar, AKCESK, me qëllim arritjen e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike, duke përcaktuar masat e sigurisë, të drejtat, detyrimet, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet subjekteve që operojnë në fushën e sigurisë kibernetike, në përmbushje të detyrave specifike do të kontrollojë infrastrukturat kritike të rëndësishme të informacionit. Për sistemet dhe rrjetet kritike të informacionit janë të detyrueshëm dy nivelet e sigurisë, për sistemet dhe rrjetet e rëndësishme të informacionit është i detyrueshëm vetem niveli i parë i sigurisë.

Bazuar në sa më lart, në mënyrë që të nisi implementimin e masave të sigurisë kibernetike për institucionin si dhe për të plotësuar mangësitë në infrastrukturë, nevojitet që pajisjet dhe software të kenë specifikimet teknike minimale si më poshtë:

1. KOMPJUTERA

Desktop 1

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|--|---|
| Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net | 7900 Pikë |
| Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: | |
| “RAM”: | 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC |
| Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”: | 500 GB SSD |
| “Disk Subsystem Controller”: | Serial ATA III 6 Gb/s |
| Karta Grafike “Graphics”: | Integrated graphic Card, min. 1 GB |
| “Media Device”: | DVD+/-RW |
| “Slots”: | Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI | |
| Portat e Komunikimit “Ports”: | Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA |
| Rrjeti “Networking”: | (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port |
| “Sound”: | Integrated Sound Card |
| “Speakers”: | Internal or Built-in Monitor |
| Siguria “Security Management”: | Embedded Security TPM 2.0 |
| Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| Tastiera “Keyboard”: | Standart Keyboard QWERTY |
| “Mouse”: | Minimum 3 Button Scroll Optical |
| Ushqimi “Power Supply” | 220 V AC, 50 Hz |
| Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”: | Energy Star |
| AKSESORËT | |
| Kabëll “Power Cord”: | Po, European |
| “Recover”: | Recover Partition |
| MONITORI | |
| Tipi “Type”: | LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin |
| Madhësia “Size”: | ≥ 21” |
| Rezolucioni “Native Resolution”: | 1920 x 1080 at 60 Hz |

| | |
|--|--|
| Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”: | 1000:1 |
| “Display Port”: | (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI |
| Koha e Rifreskimit “Response Time”: | ≤ 6 ms |
| Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”: | Energy Star |
| Ushqimi “Power Supply”: | 220 V AC, 50 Hz |
| GARANCIA | |
| Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: | 3 Vjet |

2. KOMPJUTERA

Desktop 2

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: | 11500 Pikë |
| “RAM”: | 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC |
| Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size” | 500 GB SSD |
| “Disk Subsystem Controler”: | Serial ATA III 6.0 Gb/s |
| Karta Grafike “Graphics”: | Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor) |
| “Media Device”: | DVD+/-RW |
| “Slots”: | Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI | |
| Portat e Komunikimit “Ports”: | Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor) |
| Rrjeti “Networking”: | (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port |
| “Sound”: | Integrated Sound Card |
| “Speakers”: | Internal or Built-in Monitor |

| | |
|---|--|
| Siguria “Security Management”: | Embedded Security TPM 2.0 |
| Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”: | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| Tastiera “Keyboard”: | Standart Keyboard QWERTY |
| “Mouse”: | Minimum 3 Button Scroll Optical |
| Ushqimi “Power Supply”: | 220 V AC, 50 Hz |
| Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”: | Energy Star |
| AKSESORËT | |
| Kabëll “Power Cord”: | Po, European |
| “Recover”: | Recover Partition |
| MONITORI | |
| Tipi “Type”: | LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin |
| Madhësia “Size”: | ≥ 21” |
| Rezolucioni “Native Resolution”: | 1920 x 1080 at 60 Hz |
| Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”: | 1000:1 |
| “Display Port”: | (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI |
| Koha e Rifreskimit “Response Time”: | ≤ 6 ms |
| Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”: | Energy Star |
| Ushqimi “Power Supply”: | 220 V AC, 50 Hz |
| GARANCIA | |
| Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: | 3 Vjet |

3. KOMPJUTERA Workstation Advanced (Sipas Prodhuesit)

| KARAKTERISTIKA | MINIMALE | |
|---|-----------------|---|
| TEKNIKE | | |
| Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: | | 12000 Pikë |
| “RAM”: | | 32 GB, min. DDR4 2666 MHz, ECC |
| Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”: | | (1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD |
| Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”: | | 7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD |
| “Disk Subsystem Controller”: | | Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1). |
| Karta Grafike “Graphics”: | | Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Minimum 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe |

| | |
|--|--|
| | adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation. |
| “Media Device”: | DVD+/-RW with Dual Layer DVD+R wri. Capacity |
| “Slots”: | Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16 |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI | |
| Portat e Komunikimit “Ports”: | Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor) |
| Rrjeti “Networking”: | (2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port |
| “Sound”: | Integrated Sound Card |
| “Speakers”: | Internal speakers or Built-in Monitor |
| Siguria “Security Management”: | Embedded Security TPM 2.0 |
